



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 55

2002

Shtator

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Dekret nr.3457 datë 3.9.2002	Për lejim të shtetësisë shqiptare..... 1559
Vendim i KM nr.407, datë 29.8.2002	Për mënyrën e trajtimit me strehim të invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë..... 1560
Vendim i KM nr.422, datë 12.9.2002	Për ruajtjen dhe shoqërimi e personaliteteve të larta shtetërore..... 1561
Vendim i KM nr.423, datë 12.9.2002	Për hapjen e vendkalimeve kufitare në Shishtavec dhe Orgjost, qarku Kukës, në kufirin shtetëror tokësor të Republikës së Shqipërisë me Kosovën..... 1562

Vendim i KM nr.425, datë 12.9.2002	Për rritjen e pagesës kalimtare të ushtarakëve në rezervë (lirim).....	1563
Vendim i KM nr.427, datë 12.9.2002	Për njehsimin e gradave ushtarake me funksionet organike në të gjitha nivelet e hierarkisë së komandimit dhe të drejtimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.....	1563
Vendim i KM nr.428, datë 12.9.2002	Për ndryshimin e numrit të punonjësve të Presidencës dhe për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2002, miratuar për këtë institucion.....	1572
Vendim i KM nr.429, datë 12.9.2002	Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore.....	1572
	<i>Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Jazi Uku.....</i>	1574
	<i>Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Agron Kanani....</i>	1574

DEKRET
Nr. 3457, datë 3.9.2002

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Rrok Ndoc Torta
2. Anton Rrok Torta
3. Angjelina Mark Torta (Maka)
4. Antonela Rrok Torta
5. Valentina Simo Luzi (Sevo)
6. Mateo Sotir Luzi
7. Ramazan Reshit Ferhati
8. Rukida Ramazan Ferhati
9. Fabian Ramazan Ferhati
10. Afërdita Muhamet Braho (Deshiku)
11. Anila Pandi Böswald (Macuka)
12. Irena Haki Amataj (Reçi)
13. Gladiola Fatosh Amataj
14. Gjoka Bledi Sotiraq Kruja
15. Katerina Ndreçi Uhlenbruk (Elini)
16. Miranda Mentor Danner (Bakalli)
17. Blerim Shaqir Bennek (Pepa)
18. Artan Shazeman Ismailaj
19. Besnik Ferit Lamçe
20. Manjola Aleksandër Blakçori (Murana)
21. Ermira Namik Muhameti (Abazi)
22. Mario Ilir Muhameti
23. Grei Ilir Muhameti
24. Ilirjan Xhemal Likaj
25. Fatmir Bego Alushi
26. Artan Rexhep Karruku
27. Tonin Bal Kolpeja
28. Antoneta Ndoc Kolpeja (Naraçi)
29. Gloria Tonin Kolpeja
30. Kris Tonin Kolpeja

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Alfred Moisiu

VENDIM
Nr. 407, datë 29.8.2002

**PËR MËNYRËN E TRAJTIMIT ME STREHIM TË INVALIDËVE PARAPLEGJIKË DHE
TETRAPLEGJIKË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, 17 dhe 21 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Për statusin e invalidëve paraplegjikë e tetraplegjikë” dhe të neneve 1 e 13 të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, me propozimin e Ministrisë të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit të planifikojë fonde për të pastrehët me statusin e invalidit paraplegjik e tetraplegjik, në bazë të kërkesave që organet e qeverisjes vendore i dërgojnë Entit Kombëtar të Banesave, brenda datës 1 gusht të çdo viti.

2. Organet e qeverisjes vendore t’u japin në çdo kohë statusin e të pastrehut invalidëve që përcaktohen të tillë nga komisionet mjekësore të caktimit të aftësisë për punë dhe që marrin “Dëshmi zyrtare identifikimi” nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale.

3. Përparësi në dhënien e statusit të të pastrehut dhe në trajtimin me strehim nga shteti, në mbështetje të nenit 12 të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995, kanë rastet kur:

a) familja, kryefamiljari i së cilës ka statusin e invalidit paraplegjik ose tetraplegjik, banon në mjedise që nuk janë fond banese;

b) familja, kryefamiljari i së cilës ka statusin e invalidit paraplegjik ose tetraplegjik, zotëron sipërfaqe banimi më pak se normat e strehimit në fuqi;

c) familja, një pjesëtar i së cilës ka statusin e invalidit paraplegjik ose tetraplegjik, banon në sipërfaqe nën normat e strehimit në fuqi dhe është në gjendje të vështirë ekonomike.

4. Shpenzimet e Entit Kombëtar të Banesave përballohen nga Buxheti i Shtetit në rastet kur:

a) individi i pastrehë, me statusin e invalidit paraplegjik ose tetraplegjik, është kryefamiljar;

b) familja, që ka në përbërje një pjesëtar me statusin e invalidit paraplegjik ose tetraplegjik, ka të ardhura për frymë më pak se 6 000 (gjashtë mijë) lekë në muaj.

5. Qendër banimi për individët që kanë përfituar nga statusi i invalidit paraplegjik ose tetraplegjik merret qendra ku ata kanë përfituar statusin e të pastrehut.

6. Në qytetet, ku vlera e banesave në treg është më e vogël se kostoja mesatare e ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, apartamentet të blihen, për invalidin paraplegjik ose tetraplegjik, në katet e para të banesave tip, sipas kriterëve të përcaktuara në vendimin nr.286, datë 2.6.2000 të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e blerjes dhe shitjes së apartamenteve nga Enti Kombëtar i Banesave në tregun e lirë të banesave”. Kur, me pëlqimin e familjes, apartamenti blihet në banesa të pajisura me ashensorë, diferenca ndërmjet vlerës së apartamentit me fondin limit të blerjes, sipas vendimit nr.286, datë 2.6.2000 të Këshillit të Ministrave, shlyhet nga qytetari i pastrehë.

7. Në qytetet ku vlera e apartamenteve në treg është më e lartë se kostoja mesatare e ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, dhe ky i fundit nuk investon në ndërtime të reja, qytetari me statusin e invalidit paraplegjik a tetraplegjik ose familja e tij përfiton nga tregu i lirë i banesave. Në këtë rast, Enti Kombëtar i Banesave me paraqitjen e kontratës së shitblerjes së apartamentit ndërmjet qytetarit të pastrehë dhe shitësit të apartamentit, shlyen vlerën, e cila është e barabartë me vlerën limit të apartamentit që përfiton familja. Diferenca ndërmjet vlerës së apartamentit të blerë në treg me fondin limit të apartamentit, shlyhet nga vetë familja e pastrehë.

8. Në të gjitha rastet e parashikuara në pikat 5 dhe 6 të këtij vendimi, vlera limit të apartamentit që përfiton qytetari i pastrehë shlyhet pranë Entit Kombëtar të Banesave, sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin nr.8030, datë 15.11.1995, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

9. Deri në hartimin e normave të projektimit të godinave të banimit për kategoritë me kërkesa të veçanta, të përdoren katet e para të godinave, që do të ndërtohen ose blihen nga Enti Kombëtar i Banesave, për trajtimin e personave sipas pikave 5 dhe 6 të këtij vendimi.

10. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, organet e qeverisjes vendore dhe Enti Kombëtar i Banesave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 422, datë 12.9.2002

PËR RUAJTJEN DHE SHOQËRIMIN E PERSONALITETEVE TË LARTA SHTETËRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7602, datë 9.9.1992 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet përkatëse, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Presidentit të Republikës dhe Kryeministrit u ruhet banesa ose rezidenca ku ndodhen dhe u bëhen ruajtja dhe shoqërimi me grup shoqërimi, me tri makina.

2. Kryetarit të Kuvendit i ruhet banesa ose rezidenca ku ndodhet dhe i bëhen ruajtja dhe shoqërimi me grup shoqërimi, me dy makina.

3. Zëvendëskryeministrit, Ministrit të Rendit Publik, Prokurorit të Përgjithshëm u ruhet banesa dhe u bëhen ruajtja dhe shoqërimi me grup shoqërimi, me një makinë.

4. Ministrave, Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, Kryetarit të Gjykatës së Lartë, Drejtorit të Shërbimit Informativ Shtetëror, Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Kryetarit të Bashkisë së Tiranës u bëhet ruajtja e afërt fizike, me shoqërues personal.

5. Presidentit të Republikës i ruhet banesa ose rezidenca ku ndodhet dhe i bëhet ruajtja e afërt fizike me shoqërues personal, edhe 4 vjet pas lirimit të tij nga funksioni, ndërsa Kryeministrit dhe Kryetarit të Kuvendit edhe 2 vjet pas lirimit nga funksioni.

6. Zëvendëskryeministrit, Ministrit të Rendit Publik, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të Shërbimit Informativ Shtetëror u bëhet ruajtja e afërt fizike me shoqërues personal, deri në 2 vjet pas lirimit nga funksioni.

7. Automjetet që përdoren për ruajtjen dhe shoqërimin e personaliteteve, të përcaktuara në pikat 5 dhe 6 të këtij vendimi, të vihen në dispozicion nga institucionet përkatëse, që ata kanë drejtuar.

8. Ministri i Rendit Publik, në varësi të të dhënave dhe gjendjes që paraqitet për kryerjen e shërbimit, ka të drejtë të përforcojë shërbimet për ruajtjen dhe shoqërimin e personaliteteve dhe ruajtjen e banesave të tyre.

9. Struktura dhe organika e nevojshme për ruajtjen dhe shoqërimin e personaliteteve dhe ruajtjen e banesave ose rezidencave të tyre, sipas këtij vendimi, si dhe kriteret e përzgjedhjes së efektivave që ngarkohen me këtë detyrë miratohen nga Ministri i Rendit Publik. Kohëzgjatja në shërbim e efektivave, në të njëjtin grup shoqërimi të personaliteteve të larta shtetërore, të përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij vendimi, të jetë 18 muaj.

10. Pikat 1, 2, 3, 5, 6 dhe 7 të vendimit nr.76, datë 11.2.1999 “Për ruajtjen dhe shoqërimin e personaliteteve të larta shtetërore dhe trajtimin me pagë të efektivave të këtyre shërbimeve” shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 423, datë 12.9.2002

**PËR HAPJEN E VENDKALIMEVE KUFITARE NË SHISHTAVEC DHE ORGJOST,
QARKU KUKËS, NË KUFIRIN SHTETËROR TOKËSOR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË ME KOSOVËN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 3 të nenit 24 të ligjit nr. 8772, datë 19.4.2001 "Për ruajtjen dhe kontrollin e kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e vendkalimeve kufitare në Shishtavec dhe Orgjost, qarku Kukës, në kufirin shtetëror tokësor të Republikës së Shqipërisë me Kosovën, për komunikacion kufitar.
2. Ngarkohen Ministria e Rendit Publik dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 425, datë 12.9.2002

PËR RITJEN E PAGESËS KALIMTARE TË USHTARAKËVE NË REZERVË (LIRIM)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 18 dhe 21 të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe Shërbimit Informativ Kombëtar", ndryshuar me ligjin nr.8521, datë 30.7.1999, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rritjen në masën 10 për qind të pagesës kalimtare që përfiton ushtaraku në rezervë (lirim) në zbatim të shkronjës "b" të nenit 10 të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996, me ndryshimet përkatëse.
2. Përfitojnë nga kjo rritje ushtarakët e nxjerrë në rezervë (lirim) nga strukturat e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të Ministrisë së Rendit Publik dhe Shërbimit Informativ Shtetëror.
3. Efektet financiare të përballohen nga Buxheti i Shtetit i vitit 2002, miratuar për institucionet përkatëse.
4. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Rendit Publik dhe Shërbimi Informativ Shtetëror për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2002.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 427, datë 12.9.2002

**PËR NJEHSIMIN E GRADAVE USHTARAKE ME FUNKSIONET ORGANIKE NË TË
GJITHA NIVELET E HIERARKISË SË KOMANDIMIT DHE TË DREJTIMIT TË
FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 24 të ligjit 8670, datë 26.10.2000 “Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Njehsimin e gradave ushtarake me funksionet organike, në të gjitha nivelet e hierarkisë së komandimit e të drejtimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

2. Gradat ushtarake, për ushtarakët që shërbejnë në aparatën e Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabin e Përgjithshëm, repartet dhe institucionet (autonome) në varësi të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, njehsohen me funksionet organike të përcaktuara në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Gradat ushtarake për ushtarakët që shërbejnë në Forcat Tokësore dhe repartet në varësi të tyre, njehsohen me funksionet organike, të përcaktuara në lidhjen nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Gradat ushtarake, për ushtarakët që shërbejnë në Forcat Detare dhe repartet në varësi të tyre, njehsohen me funksionet organike të përcaktuara në lidhjen nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Gradat ushtarake, për ushtarakët që shërbejnë në Forcat Ajrore dhe repartet në varësi të tyre, njehsohen me funksionet organike të përcaktuara në lidhjen nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Gradat ushtarake, për ushtarakët që shërbejnë në Komandën e Mbështetjes Logjistike dhe repartet në varësi të saj, njehsohen me funksionet organike të përcaktuara në lidhjen nr.5, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

7. Gradat ushtarake, për ushtarakët që shërbejnë në Komandën e Doktrinave dhe të Stërviutjes dhe repartet në varësi të saj, njehsohen me funksionet organike, të përcaktuara në lidhjen nr.6, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

8. Ushtarakëve të Forcave të Armatosura, për çdo gradë ushtarake, t'u jepet një shpërblim mujor në masën e përcaktuar në lidhjen nr.7, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Masa e shpërblimit mujor për gradë, të rritet sa herë dhe në të njëjtin raport me rritjen e pagave të ushtarakëve të Forcave të Armatosura.

9. Njehsimi i gradave ushtarake me funksionet organike, në të gjitha nivelet e hierarkisë së komandimit e të drejtimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të përfundojë brenda vitit 2003.

10. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për nxjerrjen e akteve të nevojshme në zbatim të këtij vendimi.

11. Vendimi nr.351, datë 1.8.1994 i Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e gradave në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë” shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 korrik 2003.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 428, datë 12.9.2002

PËR NDRYSHIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE TË PRESIDENCËS DHE PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2002, MIRATUAR PËR KËTË INSTITUCION

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të neneve 7 e 8 të ligjit nr.8847, datë 19.12.2001 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2002” me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve të Presidencës, i miratuar me vendimin nr.82, datë 14.3.2002 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin, për vitin 2002, të numrit të punonjësve të institucioneve buxhetore”, ndryshohet nga 45 në 60.

2. Presidencës, në buxhetin e miratuar për vitin 2002, t’i shtohet fondi prej 4 000 000 (katër milionë) lekësh për të përballuar efektet financiare që rrjedhin nga rritja e numrit të punonjësve.

3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 tetor 2002.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 429, datë 12.9.2002

PËR KUSHTET E PËRFITIMIT, SHUMËN DHE PROCEDURËN E DHËNIES SË PENSIONEVE TË POSAÇME SHTETËRORE DHE TË SHTESAVE TË PENSIONEVE TË POSAÇME SHTETËRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet përkatëse, me propozimin e Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pension të posaçëm shtetëror ose shtesë pensioni të posaçëm shtetëror përfiton personi, që plotëson kushtet e përcaktuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të nenit 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për ndryshimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet përkatëse.

2. Moshë dhe vjetërsia në punë për përfitimin e pensionit të posaçëm shtetëror është përcaktuar në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993, me ndryshimet përkatëse.

3. Personave të cilësuar të paaftë për punë, me vendim të KMCAP-it, mund t’u jepet pension i posaçëm shtetëror ose shtesë pensioni i posaçëm shtetëror edhe nën kufijtë e moshave të përcaktuara në nenin 92 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, me ndryshimet përkatëse.

4. Kërkesa për përfitimin e pensionit të posaçëm shtetëror ose shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror bëhet nga i interesuari ose nga organizatat a shoqatat, nëpërmjet këshillit të qarkut të vendbanimit të personit të propozuar, ministrave përkatës, Kryeministrit, Kryetarit të Kuvendit ose Presidentit.

Këshilli i qarkut, Ministri, Kryeministri, Kryetari i Kuvendit ose Presidenti, pasi shqyrtojnë kërkesën dhe dokumentacionin shoqëruar, i propozojnë Këshillit të Ministrave, me vendim të argumentuar, dhënien e pensionit të posaçëm shtetëror ose shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror. Vendimi i paraqitet Këshillit të Ministrave, së bashku me dokumentacionin që kërkohet sipas këtij vendimi. Kur kërkesa nuk vlerësohet si e drejtë, i kthehet kërkuarit, e shoqëruar me argumentet përkatëse.

Ministri, Kryeministri, Kryetari i Kuvendit ose Presidenti mund të propozojnë drejtpërdrejt, me nismën e tyre, pavarësisht nga mosparaqitja e kërkesës së të interesuarit, dhënien e pensionit të posaçëm shtetëror ose shtetës së pensionit të posaçëm shtetëror, personave që vlerësohen se plotësojnë kriteret ligjore.

5. Propozimi, që paraqitet në Këshillin e Ministrave, për përfitimin e pensionit të posaçëm shtetëror ose shtesë pensioni të posaçëm shtetëror, shoqërohet me:

- kërkesën e të interesuarit, të shoqatës a të organizatës, e cila duhet të përmbajë: gjeneralitetet, emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, vendlindjen etj;

Në rastin e propozimit të drejtpërdrejtë, gjeneralitetet jepen në vendim.

- vendimin e institucionit propozues, të shoqëruar me relacionin, i cili argumenton arsyet e propozimit dhe paraqet procedurën e ndjekur, etj;

- certifikatën e gjendjes civile;

- vërtetimin nga organet e sigurimeve shoqërore nëse merr pension dhe, nëse merr pensionin, vërtetimin për masën e pensionit;

- vërtetimin nga KMCAP-i për personat e paaftë për punë;

- kopjet e noterizuara të dokumenteve, që vërtetojnë meritat e veçanta të personit për të cilin bëhet propozimi, si titujt, medaljet, urdhrat etj;

- kopjen e noterizuar të dokumentit të statusit për përfituesit, sipas shkronjës “c” të nenit 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993.

6. Pensioni i posaçëm shtetëror nuk mund të jetë më i ulët se pensioni bazë dhe as më i lartë dhe dyfishi i pensionit maksimal.

Kufiri maksimal i shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror të jetë deri në pensionin maksimal, por shuma e pensionit që i takon sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

7. Për shqyrtimin e dokumentacionit për pension të posaçëm shtetëror ose shtesë pensioni të posaçëm shtetëror ngrihet një komision i veçantë. Përbërja dhe rregullorja e funksionimit të këtij komisioni miratohen nga Kryeministri. Komisioni përgatit relacion për plotësimin ose jo të kushteve të përcaktuara me ligj dhe me këtë vendim dhe ia paraqet Kryeministrit.

8. Pensioni, data e fillimit të pensionit të posaçëm shtetëror ose shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror caktohen me vendim individual të Këshillit të Ministrave.

9. Pensioni i posaçëm shtetëror ose shtesa e pensionit të posaçëm shtetëror indeksohen sa herë dhe në masën që indeksohen pensionet e pleqërisë, të përfituara nga ligji nr.7703, datë 11.5.1993.

10. Instituti i Sigurimeve Shoqërore administron pensionet e posaçme shtetërore dhe shtesat e pensioneve të posaçme shtetërore. Në buxhetin e sigurimeve shoqërore, çdo vit, parashikohen fonde për 10-15 pensione të posaçme shtetërore ose shtesa pensionesh të posaçme shtetërore.

11. Shpenzimet për administrimin dhe pagesën e këtyre pensioneve të përballohen nga Buxheti i Shtetit.

12. Vendimi nr.152, datë 5.4.1994 i Këshillit të Ministrave, me ndryshimet përkatëse, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

KËRKESË

Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Kavajës është paraqitur kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Jazi Uku i datëlindjes 1966, lindur dhe banues në Lekaj, Kavajë.

KËRKESË

KËRKUESE: Bukuroshe Kanani e datëlindjes 1966, lindur dhe banuese në Fier.

OBJEKTI: Shpalljen të zhdukur të bashkëshortit tim Agron Kanani, në bazë të nenit 375, 376 të Kodit të Procedurës Civile.

Sipas dëshmive të personave të ndryshëm, rezulton se gomonia është mbytur me të gjithë personat që ishin në të.

Në këto kushte, kërkoj nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Fierit, shpalljen të zhdukur të bashkëshortit tim Agron Kanani.

KËRKUESJA
Bukuroshe Kanani





Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:

Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

- Kodin Penal (të azhurnuar);
- Kodin e Procedurës Penale (të azhurnuar);
- Kodin Civil (të azhurnuar);
- Përmbledhjen e legjislacionit në fushën e transporteve (Kodi Rrugor dhe ligji për transportet) (e azhurnuar);
- Kodin Zgjedhor (të azhurnuar);
- Kodi doganor (Dispozitat zbatuese të Kodit Doganor).



U dorëzua për shtyp më 16.9.2002
Doli nga shtypi më 17.9.2002

Tirazhi: 4250 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë